



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**  
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**  
**DEKANI**

Nr. 33 prot.

Tiranë më 14 / 10.05.2021

**Të nderur kolegë!**

Bazuar në vendimin e Rektorit nr. 11, datë 11.05.2021, "Mbi marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 në Universitetin e Arteve", pas vlerësimit të urdhërit të Ministrisë së Arsimit nr. 89, dt. 10.05.2021, dhe shkresës me nr. 2668/1, dt. 10.05.2021, me të njëjtën temë, vendosi që:

**Duke filluar nga data 17 maj 2021**

1. Lëndët teorike duke respektuar orarin do e vazhdojnë dhe mbyllin procesin e leksioneve vetëm në versionin online.
2. Është e domosdoshme që sistemi online të vazhdojë të ofrohet për gjithë ata studentë që banojnë larg, jashtë kufinjve, apo që e kanë të pamundur për të zhvilluar konsultime fizikisht në ambjete të fakultetit.
3. Të fillojë, ose të intensifikohet procesi i konsultimeve në lëndët e atelierit, proces që ka filluar disa muaj më parë, por që me afrimin e fundit të sezonit (dt. 18 qershor 2021) bëhet i domosdoshëm për përfundimin me sukses të vitit shkollor. Në çdo atelier ku shikohet e nevojshme të vendoset një model për një normalizimi sa më të shpejtë të procesit mësimor.
4. Konsultimet të zhvillohen në klasa, atelie dhe laboratorë në një numër të kufizuar studentësh, (maksimumi 10) gjithnjë duke respektuar distancat fizike që garantojnë një mbarvajtje sa më të mirë të gjithë procesit. Në rastet kur ato do i kalojnë numrin e 10 studentëve rekomandohet ndarja e tyre në 2 grupe, të cilët mund ta zhvillojnë konsultimet në dy orare të ndryshme.
5. Për çdo specifikë, secili pedagog të përcaktojë vetë mënyrën më të përshtatshme për zhvillimin e konsultimeve, bazuar në veçantinë e programit dhe produktit final. Për çdo pasiguri mund të konsultoheni me Drejtuesin e Njesisë Bazë.

**Mbi sezonin e provimeve që po afron, bazuar në vendimet në fuqi**

1. Në fillim të javës që vjen do të publikohen datat e provimeve të mbartura dhe atyre përfundimtare të vitit akademik 2020-2021.
  - Për provimet teorike, si të mbartura, apo ato përfundimtare pedagogët respektivë të përcaktojnë modelin më të përshtatshëm për zhvillimin me sukses të procesit. Këshillohen dy modelet bazë, ai fizik duke respektuar maksimalisht distancat, ndarë në 2 a më shumë grupe, apo versionet alternative me gojë, ose online.
  - Në rastet kur provimi do të zhvillohet me shkrim në Lektorium sigurohuni që numri i studentëve të mos i kalojnë 20-25 studentëve, dhe secili prej tyre të vendoset në një rresht më vete në formë të kryqëzuar në skajet e rreshtit.
  - Rekomandohen maksimalisht dritaret e dyert e hapura për një ajrosje sa më të plotë të ambjeteve. Gjithashtu rekomandohet një distancë 60 min nga njëra seancë provimi në tjetrën për një ajrosje maksimale të ambjeteve.
2. Si gjithnjë prioritet maksimal mbetet shëndeti i të gjithëve, i cili mund të parandalohet vetëm nga respektimi maksimal i distancave, mbajtja e maskës në çdo moment, si dhe higjienizmi i duarve dhe mjediseve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Në raste të veçanta kur një student, apo disa prej tyre ndodhen fizikisht të pamundur të shihet me prioritet zhvillimi i provimit në versionin online. Pedagogët e lëndës të kenë një plan rezerve për të përmbushur këtë kërkesë specifike, me qëllim evitimin e ardhjes së tyre në këtë kohë pandemie. Vlerësimi i kësaj alternative mbetet në gjykimin personal të pedagogut.

#### **Për shikimin e punëve në atelier**

1. Për shikimin e detyrave në atelier duhet të respektohen ndarja e studentëve në grupe jo më mëdha se 5 studentë, të cilët duhet të vihen në orare të ndryshme psh. Grupi 1 ora 9:30 deri më 10:30, Grupi 2 ora 10:30 deri më 11:30, dhe kështu me rradhë. Duke pasur parasysh që grupi më i madh i studentëve nuk e kalon nr. 18 studentë, (për një mesatare 10 studentë) sygjerohet ndarja në 2- 3 grupe. Kjo bëhet për të evituar grumbullimin e studentëve në ambjete të brendshme të fakultetit, një fenomen që duhet evituar me bashkëpunimin sa më rigoroz të stafit pedagogjik, në bashkëpunim dhe me administratën e Fakultetit. Për çdo nevojë mos hezitoni të aganzhoni stafin ndihmës të administratës, apo dhe laborantët respektiv.
2. Gjatë kohës së shikimit të punëve në atelier të bëhet kujdes për respektimin e distancave, vendosjes së domosdoshme të maskës nga gjithë stafi dhe studentët.
3. Për provimet përfundimtare, diplomimi për Nivelin Bachelor dhe Master, procesi do të zhvillohet pa prezencën e publikut, por vetëm me prezencën e studentit dhe komisionit.
4. **Përgjatë gjithë procesit jeni të lutur të respektoni me rigorozitet maksimal të gjithë masat e paralajmëruara antikovid, distancimin social, mbajtjen e maskës në çdo moment dhe hapsirë, dizifektimin sa më të shpeshtë duarve.**

Për çdo udhëzim apo vendim të ri që mund të vijë nga Ministria do të viheni në dijeni.

Për çdo paqartësi kontaktoni me Drejtuesin e Njesisë Bazë.

Punë të mbarë dhe suksese

Shefi i Departamentit të Arteve të Aplikuara

**Dr. Ermir Hoxha**

Shefi i Departamentit të Pikturës

**Dr. Mikel Temo**

Shefi i Departamentit të Skulpturës

**Prof. Sadik Spahija**



**PROF. ARTAN PEQINI**

**DEKAN**

**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**